32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimi të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimi siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimi përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi;

b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PERMBAJTJA

1. Informatat Bazike.....	
○ Detyra Projektuese	
2. Përshkrimi Teknik.....	5
○ Hyrje	
○ Koncepti i zgjidhjes inxhinierike	
○ Kushtet e përgjithshme të punës	
○ Kushtet e veçanta	
3. Shqyrtimi i Gypsjellësit.....	20
○ Dezinfektimi i Sistemit	
4. Llogaritë dhe dimensionimi.....	21
○ Analiza e hargjimeve	
○ Përlllogaria hidraulike	
○ Skema hidraulike	
○ Plani i situacionit	
○ Prerjet gjatësore	
○ Skema e nyjeve (disajni i nyjeve)	

Informatat bazike

DETYRA PROJEKTUESE

- Gjatësia e sistemit është $L=130.0$ m'. Kjo gjatësi është orientuese dhe e njëjta nuk mund të ndikoj në revidimit e ofertës pas nënshkrimit të kontratës.
- Analiza dhe studimi i nevojave për vendbanimin si dhe vlerësimi i nevojës së vendbanimit për periudhën prej $T=25$ vjet.
- Përpilimi i dokumentacionit komplet teknik në nivelin e projektit kryesor detal (ekzekutiv) me të gjitha elementet e nevojshme për këtë lloj projekti. Projekti duhet të mbështet në metodikën e pranuar si dhe në normat DIN si dhe udhëzuesit DVWG si rregullave tjera teknike që nënkuptohen.

• Përshkrimi teknik

Në bazë të detyrës projektuese dhe informatave shtesë, në përputhshmeri me kërkesat e klientit (Autoritet Kontraktues – Ujësjiellësit dhe Komuniteti) është vendosur korniza e projektit konform rregullave teknike të aplikueshme dhe duke u mbështetur në normat evropiane EC si dhe posaçërisht në normat DIN.

Projekti i infrastrukturës është kompleks dhe si i tillë është trajtuar së pari në mënyrë analitike duke ju përmbajtur rregullave teknike, planit rregullues urbanistik (nuk egziston-gjendjes aktuale) dhe në mënyrë specifike kushteve të kërkuara nga ana e Komunes në detyrën projektuese dhe në informatat shtesë.

Kushtet e përgjithshme të punës

Qëllimi i prezantimit të kushteve të përgjithshme është që të sigurohet kryerja kualitative e punimeve dhe në pajtim me rregullat dhe standardet teknike.

Punëkryerësi është i obliguar që ti përmbahet me përpikëri aplikimit të rregullave dhe standardeve teknike gjatë realizimit të punimeve që janë lëndë e këtij projekti.

Brezi punues

Organi mbikëqyrës dhe kryerësi i punimeve bashkërisht do të caktojnë gabaritin e brezit punues duke pasur parasysh plotësimin e kushtit për ekzekutim pa pengesa të punimeve, në sa më pak sipërfaqe të shfrytëzuar, në mënyrë që shpenzimet e dëmtimit të tokës dhe infrastrukturës të jenë sa më të vogla.

Organi mbikëqyrës dhe kryerësi i punimeve bashkërisht do të caktojnë lokalitetin më të përshtatshëm për ndërtimin e objekteve të përkohshme si dhe sipërfaqes për deponimin e materialit.

Investitori është i obliguar që t'ia dorëzojë trasenë kryerësit të punimeve dhe me kohë ta sigurojë terrenin e lirë për ekzekutimin e punimeve paraprake pa pengesa.

Shënimet e trasesë

Punëkryerësi do ti kryej të gjitha inçizimet gjeodezike dhe është i detyruar që ti mirëmbajë shenjat e përhershme, reperët e tjera. Para fillimit të punimeve duhet të bëhet shenjëzimi detal i trasesë dhe i njëjti të përdoret për plotësimin e dokumentacionit teknik në fund të punimeve. Per qdo ndryshim te trases (per shkaqe te ndryshme-probleme pronesore apo te tjera)kontraktori duhet ta beje fare ne funde projektin ne baze te puneve te kryera.

Uji për nevoja të ekzekutuesit

Kryesi i punimeve duhet vetë ta sigurojë ujin e nevojshëm për shqyrtimin-testimin e gypsjellësit gjatë ekzekutimit të punimeve. Detyrë e tij është të sigurojë mjetet transportuese të nevojshme për sjelljen e ujit deri tek të gjitha pikat në të cilat nevojitet.

Projekti dhe dokumentacioni kontraktues

Punimet duhet të ekzekutohen sipas kuotave të inçizuara dhe të aprovuara nga organi mbikëqyrës, masave, dimensioneve dhe detaleve të cilat janë paraqitur në vizatimet e projektit si dhe sipas udhëzimeve të organit mbikëqyrës.

Nëse dokumentacioni teknik nuk është i plotë, ekzekutuesi duhet me kohë të kërkojë plotësime dhe udhëzime të nevojshme prej organit mbikëqyrës.

Të gjitha masat nga dokumentacioni teknik duhet të kontrollohen në vend.

Ndryshimet që pasojnë gjatë ekzekutimit të punimeve në terren diktojnë plotësimin e dokumentacionit teknik. Plotësimin e dokumentacionit teknik e bënë punëkryerësi në marrëveshje me investitorin.

Materiali

Materiali për ekzekutimin e punimeve duhet ti përgjigjet standardeve në fuqi si dhe rregullave teknike. Të gjitha materialet duhet të jenë të licencuar sipas normave DIN, ISO dhe EC.

Kualitetin e materialit i cili instalohet si dhe kualitetin e prodhimeve tjera të gatshme ekzekutuesi e dëshmon me ateste të shqyrtuara nga institucionet përkatëse.

Atestet dhe rezultatet e shqyrtimeve, ekzekutuesi ia dorëzon organit mbikëqyrës dhe e njëjta duhet të evidentohet në ditarin e punës.

Shpenzimet e dëshmisë së kualitetit të materialit si dhe të prodhimeve të gatshme nuk paguhën veçanërisht.

Kadastra e instalimeve

Para fillimit të punimeve, punëkryerësi është i obliguar që të kërkojë nga investitori inçizimin kadastral të instalimeve ekzistuese nëntokësore (instalimeve elektrike, telefonit, ujësjellësit dhe kanalizimit). Të gjitha risitë që paraqiten gjatë realizimit të punimeve, punëkryerësi dhe organi mbikëqyrës do ti zgjedhin së bashku.

Kushtet e veçanta

Matjet gjeodezike

Pas dorëzimit të kantierit, punëkryerësi është i obliguar të bëjë matjet dhe inçizimin detal gjeodezik. Për këtë arsye, punëkryerësi duhet që pas matjeve të bëra gjeodezike ti krahasoj të dhënat dhe në rast të dallimit ndikues të informoj mbikëqyrësin e punimeve dhe së bashku të bëjnë eventualisht ndryshimet e nevojshme. Të njëjtat të dhëna gjeodezike, punëkryerësi është i obliguar që në fund të punimeve ti dorëzoj të investori dhe të administruesi i sistemit. Për përcaktimin e trases së ujësjellësit punëkryerësi duhet të sherbehet me matjet gjeodezike sipërfaqësore të cilat i janë dorëzuar klientit në formën elektronike dhe në letër si dhe të dhënat e ofruara në pikën 5.4.2 të hijëzuara ku janë paraqitur koordinatat gjeodezike x , y , z . Këto koordinata korrespondojnë me pikat e skemës hidraulike që është përdorë për llogaritë hidraulike.

Gërmimi i kanaleve për vendosjen e gypave

Kanalet për vendosjen e gypave do të gërmohen në trotuare, gërmimi do të bëhet me makinë dhe një pjesë me dorë.

Sasia e dheut të gërmuar duhet të transportohet në vendin e caktuar nga investitori respektivisht deri në deponinë legale.

Gjerësia e kanalit është e ndryshueshme në mvarshmeri të diametrit të gypit (shih detalet e kanalit) ose sipas standardeve DIN që mundëson montimin e gypave në kanal.

Thellësia e kanalit është paraqitur në profilet gjatësore por jo më e vogël se $h=1,5$ m të cilën e imponojnë dimensionet e pjesëve fazonike.

Gërmimi i kanaleve do të bëhet sipas kuotave të treguara në profilin gjatësorë. Planifikimi i fundit të kanalit bëhet me saktësi prej ± 3 cm. Në rastet kur kryerësi i punimeve gjatë gërmimit gabimisht gërmon nën kuotat e projektuara, ai është i obliguar që të njëjtat ti sanoj duke bërë mbushjen me zhavorr dhe duke e ngjeshur derisa të arrihet tek kuota e projektuar. Sanimin e këtillë punëkryerësi e bënë në shpenzime të veta.

Në pjesët e terrenit ku fundi i kanalit, sipas mendimit të organit mbikëqyrës, nuk ka aftësinë e nevojshme mbajtëse që të pranojë ngarkesat nga gypi, duhet të veprohet si vijon:

Kanali duhet të hapet deri tek shtresa me aftësi të mjaftueshme mbajtëse, kurse thellësia e gërmuar do të mbushet me zhavorr ose gurë të thyer me ngjeshje deri sa të arrihet kuota e projektuar. Ngjeshja e shtresës së mbushur bëhet në trashësi 20 cm deri në aftësinë mbajtëse të nevojshme por jo më pak se 200 KN/m^2 dhe densitet relativ 0,97 %.

Gypi do të përforcohet me ankerë betoni nëse organi mbikëqyrës vlerëson se nga ndërrimi i shtresave të dheut mund të paraqitet efekti i “traut të thjeshtë” ose i “konsolës”.

Mbulimi i kanalit

Mbulimi i kanalit bëhet në dy faza :

Faza e parë :


Mbulimi parcial para testimit nën shtypje të gypsjellësit.

Mbulimi parcial duhet të bëhet pasi është bërë montimi i gypave, montimi i fazonerisë së nevojshme, ankorimit të kthesave horizontale dhe vertikale. Materiali që përdoret gjatë mbulimit në fazën e parë duhet të jetë rërë e imët, fraksion 0/16 mm në mënyrë që të mos bëhet dëmtimi i gypave. Gjatë mbulimit në këtë fazë, punëkryerësi duhet të ketë kujdes të posaçëm derisa bënë ngjeshjen e materialit përreth gypit. Mbulimi parcial bëhet në atë mënyrë që nuk mbulohen lidhjet për arsye të vërejtjes më të lehtë të defekteve eventuale dhe mënjanimit të tyre. Sasia e materialit e cila duhet të përdoret duhet të jetë e mjaftueshme që të shërbejë si kundërpeshë forcës nga shtypja e ujit që formohet gjatë shqyrtimit.

Kjo mënyrë e mbulimit të kanalit vlen vetëm për atë pjesë të gypsjellësit në raste kur e kërkon nevoja e terrenit për PE

Për rastin e këtij projekti gypi mbulohet sipas skicës se

mëposhtme:



Për gypsjellësin me gypa PE, mbulimi (sipas udhëzimeve të prodhuesit) bëhet me zhavorr dhe rërë. Lidhjet e gypave të PE mund të realizohen në kanal apo jashtë kanalit dhe si të montuar të vendosen pastaj në kanal.

• **Faza e dytë : Mbulimi i kanalit pas testimit të suksesshëm të gypsjellësit**

Pas përfundimit të suksesshëm të shqyrtimit nën shtypje, duhet të fillohet me fazën e mbulimit përfundimtar. Mbulimi bëhet duke filluar me mbulimin e pjesëve të pa mbuluara të gypsjellësit dhe pastaj vazhdohet me mbulimin e kanalit në shtresa prej 25cm duke e ngjeshur. Punëkryerësi duhet të ketë kujdes në pjesët e kanalit ku ka ujëra, mbushja nuk guxon të bëhet para se të bëhet largimi i ujit dhe baltës.

• **Faza e tretë: Shtrirja e shtresës së fundit**

Pas përfundimit të suksesshëm të shqyrtimit nën shtypje dhe mbulimit në fazën e dytë fillon shtrirja e shtresës së fundit të zhavorrit lidhës sipas kërkesave të konstruksionit për ndërtimin e trotuareve me gurë betoni të parapërgatitur. Kjo shtresë nuk guxon të jetë më e vogël se 20cm dhe duhet të ngjeshët deri në densitetin e kërkuar për këtë lloj pune. Pas përfundimit të shtrirjes, rrafshimit dhe dendësimit sipërfaqja e trajtuar duhet të pastrohet dhe bëhen përgatitjet për vazhdimin e punimeve në veshjen e sipërfaqeve me materialet e caktuara në projekt.

Instalimi i gypave

Në punët montuese hyjnë: sigurimi, transporti, bartja përgjatë kanaleve, vendosja në kanale e materialit, rrafshimi i zhavorrit si dhe montimi i gypave dhe pjesëve fazonike.

Për ekzekutimin pa pengesa të punëve të montimit, kanalet duhet të përgatitën në mënyrë të rregullt dhe të gjitha parapërgatitjet të bëhen me kohë.

Të gjitha lidhjet e gypave duhet të ekzekutohen në atë mënyrë që të sigurojë ujëjopërshkueshmëri gjë që do të dokumentohet me rastin e shqyrtimit të gypave nën shtypje.

Lidhjet e gypat e PEHD 100 do të realizohet me mënyrën e saldimit (elektrofuzion) ose termosaldimit. Në rastet e diametrave të vegjël mund të përdoren edhe lidhjet fazonike si varianti i mundshëm për ekzekutim.

Gjatë ekzekutimit të lidhjeve (vazhdimeve) të gypave të PEHD 100 duhet përmbajtur udhëzimeve të prodhuesit.

Para montimit, gypat duhet të jenë të pastruar nga ana e brendshme. Asnjë mjet apo çka do e ngjashme nuk duhet të lihet në brendësi të gypave dhe të gjitha vrimat duhet të mbyllen me prizat e përshtatshme të drurit duke ia përshtatur fundeve të hapura dhe duke futur gypin së paku 15cm. Për të penguar dheun dhe çfarëdo sendi të jashtëm të hyjë brenda gypave, pjesët përfunduese të gypave duhet të mbrohen duke i mbyllur me mbulesa të përshtatshme në fund të çdo ditë pune ose kurdo kur puna ndërpritet për ndonjë periudhë të kohës ose kur punishtja është pa mbikëqyrje. Para fillimit të punës fundi i gypave duhet të pastrohet.

Gypat që instalohen duhet të shtrihen me tërë gjatësinë e tij në bazën e kanalit (fundin e kanalit) në mënyrë që të mos paraqiten rastet e “traut të thjeshtë” apo “konzolës”.

Para mbushjes-mbulimit të kanaleve bëhet shqyrtimi i gypave nën presion provues.

Dezinfektimi dhe shpëlarja e gypave bëhet gjithashtu para lëshuarjës së gypsjellësit në eksploitim.

Gypsjellësi në përgjithësi është nga materiali i PE 100, me shtypje të lejueshme punuese PN10 (10 bar). Në këtë rast kemi të bëjmë me ndërrim të gypit dhe si i tillë nuk ka nevojë të një përlllogaritje detale hidraulike.

Diametri i përvetësuar plotëson nevojën e furnizimit me ujë për shfrytëzuesit e prekur nga ndërrimi i gypit me një rezervë të lejueshme pa marrë parasysh komponentët e favorshme të materialit të PE në raport me materialin AC.

Karakteristikat teknike të gypsjellësit duhet ti plotësojnë kushtet sipas ISO 161/1 dhe të gjitha kërkesat sanitare dhe teknike sipas ligjeve dhe normave në fuqi.

Gypat të ndërtuar nga ky material kanë këto përparësi:

- Pesha specifike e ulët
- Fleksibiliteti i lartë
- Rezistenca e lartë ndaj kemikaljeve
- Lidhja e lehtë dhe jetëgjatë përmes saldimit
- Rezistenca e lartë ndaj temperaturave
- Qëndrueshmëria në lëvizje nëntokësore
- Sipërfaqja e brendshme e gypave është e lëmuar me rezistencë të lartë kundër ngjitjes së mbeturinave
- Nuk janë të dëmshme nëse vinë në kontakt me prodhime ushqimore

Lidhja e gypave dhe pjesëve fazonike duhet të bëhet përmes tri metodave:

Termosaldimit (ngjitja e dy anëve të gypit me makinë termosalduese)

Elektrofuzionit (vendosja e gypave në unaza polimere dhe përmes makinës së elektrosaldimit shkrijë në rezistencë elektrike e anës së brendshme të unazës)

Lidhja përmes flanshave me adapter

Secila nga metodat e cekura mund të përdorën varësisht nga vendi i lidhjes.

Të gjitha punët instaluese dhe montuese duhet ti përmbahen rregullave teknike në fuqi, planeve të ekzekutimit dhe sqarimeve të mbikqyerësit të punimeve.

Të gjitha masat e ndërmarra në ndërtimin e sistemit të ujësjellësit duhet ti përmbahen rregullave DVGW (Deutsche Vereinigung fuer Gass und Wasser) dhe normave DIN dhe EC (shiko përmbajtjen e Normave të shfrytëzuara në fund të projektit).

Gypat prej PEHD

Polietileni PEHD ka një peshë të vogël specifike, fleksibilitet të mirë, rezistencë ndaj goditjeve edhe në temperature të ulëta në krahasim me materialet tjera të ujësjellësit sikurse janë çeliku, PVC, AC etj. Jetëgjatësia e tij dhe aftësia e vjetërsisë së ngadalshme e bën këtë material shumë ekonomik ndërsa teknikisht shumë të volitshëm (humbje të vogla hidraulike, rrjedhshmëri minimale, etj).

Fleksibiliteti i Polietilenit do të thotë se gypat e PE lehtë adaptohen në ambient dhe në ndryshimet tjera nga gurët ose lëvizjet e dheut. PE është material reciklues duke përdorur grirjen dhe teknikën e pastrimit. Përdorimi i lejueshëm i materialit të recikluar shpesh ceket në standardet e gypave.

Kërkesat që duhen plotësuar për gypat e ujit të pijshëm

Materiali i gypave nuk duhet të ketë ndikim biologjik apo kimik në ujin i cili kalon nëpër to. Ndikimi biologjik varet nga natyra e sipërfaqes në kontakt me ujin. Pasi që PE është jokoroziv kjo do të thotë se pjesa e brendshme do të mbetet e rrafshët. Hulumtimet e bëra në gypa pas 15-20 vjetëve të përdorimit tregojnë se ekziston vetëm një shtresë e hollë e materialit të huaj (2-5mm), në përgjithësi zall i cili përdoret për pastrimin e ujit. Të gjitha shkallët e PE duhet të jenë të aprovuara për kontakt me ushqim. Të gjitha materialet tjera paraqesin rrezik potencial për të ndikuar në shije dhe aromë të ujit i cili kalon nëpër to. Uji mund të ndryshojë ngjyrën nga materialet e korroduara p.sh. niveli i ndikimit të materieve organike duhet të jetë zero.

Standardet e kualitetit dhe specifikimet

rrjetit të ujësjellësit kërkon kualitet nëpër çdo shkallë të procesit: nga prodhimi lëndës së parë deri te prodhimi I gypave dhe instalimi I tyre. Lënda e pare dhe kërkesat për gypa janë të specifikuara në standardet internacionale dhe nacionale (ISO 4427, CEN TC 155 SS 20, prEN 12201).

Klasifikimi i PE për gypa nën presion

Jetëgjatësia e gypit varet nga kushtet në të cilat operon një gypsjiellës, duke përfshirë ngarkesën dhe ambientin. Një jetë minimale prej 50 vjetëve merret si standard. Në mënyrë që të përshpejtohen testet ashtu që të jemi të gatshëm të parashikojmë sjelljen e gypit përgjatë kësaj kohe: gypat e PE testohen në temperature të ngritura (60°C dhe 80 °C) si dhe në temperature të ambientit (20°C). E tërë procedura është e përshkruar në ISO/TR 9080. Qëllimi është që të jemi në gjendje të parashikojmë nivelin e stresit të ky material dhe mund të funksionojë në periudhë 50 vjeçare në temperature prej 20°C pa rrezik të dështimit.

Rrezja e lakimit

Gypat e polietilenit karakterizohen me fleksibilitetin e tyre, e cila rezulton me instalim të lehtë dhe të shpejt duke anashkaluar problemet e lidhjeve gjatë instalimit dhe zvogëlimin e nevojës për lidhëse speciale.

Tabelat vijuese tregojnë aftësinë lakuese, relative me diametrin nominal në raport me trashësinë e murit (SDR) si dhe të temperaturës.

Punimet e betonit

Përzierja, vendosja në vepër si dhe ngjeshja e betonit bëhet në mënyrë mekanike. Kualiteti i betonit dhe i komponentëve të tij duhet ti përgjigjet kërkesave të rregullave teknike dhe standardeve në fuqi si dhe kërkesave të veçanta të projektit

Shqyrtimi i betonit bëhet nga materiali i marrë në vendin e vendosjes në vepër. Shqyrtimin e bën institucioni përkatës. Mostrat në kubëza ose cilindër i siguron punëkryerësi ndërsa koston e shqyrtimit duhet ta mbuloj investori.

Në përgjithësi sigurimi i kualitetit të betonit duhet të jetë konform normave DIN 1045, ENV 206.

Punimet e armimit

Furnizimi, transporti, prerja, pastrimi, lakimi dhe montimi i armaturës bëhet sipas planeve të armaturës. Punëkryerësi është i obliguar që para fillimit të punëve të armaturës të njoftohet me planin e armaturës dhe të bëjë kontrollin në bazë planit të armaturës për pusetat e ujësjellësit.

Kualiteti i çelikut duhet ti përgjigjet rregullores së përkohshme për beton dhe beton-arme ose normave DIN 1045.

Pusetat

Pusetat do të ndërtohen nga betoni i armuar MB30, me trashësi të mureve 20 cm, pllaka e sipërme të jetë poashtu nga betoni i armuar MB30, por armimi bëhet në dy zona. Para se të bëhet betonimi i pllakës së sipërme, duhet të vendoset (montohet) unaza metalike e kapakut të pusëtës. Kapaku i pusëtave duhet të jetë adekuat për komunikacion të rendë, me aftësi mbajtëse 40 ton.

Pusetat nuk mund të ndërtohen nga elemente të parapërgaditura ngase dimensionet e tyre varen nga pjesët fazonale që duhet të instalohen në të.

Muret e pusëtës ndërtohen (betonohen) mbi pjesët vazhduese (FF) dhe të njëjtat lidhen sipas skemës së montimit të pjesëve fazonike. Të gjitha valvolat dhe pjesët tjera fazonike duhet të montohen brenda pusëtës duket lejuar hapësirë të mjaftueshme për manipulim si dhe intervenim në rast nevojë. Në pllakën e epërme, në njërin skaj montohet kapaku metalik duke ju përmbajtur planit të pahive si dhe planit të armaturës të paraqitur në projekt.

Përgatitja e kallëpeve për betonim bëhet nga të dy anët e mureve, prandaj edhe gjurmimi bëhet më i gjerë për shkak të kallupimit nga jashtë. Në secilën anë do të bëhet hidroizolimi me shtresë bituminoze dhe rreth pusëtës drenazha e cila duhet të ketë dalje në kanalizimin atmosferik ose fekale.

3 Shqyrtimi i gypsjellësit

3.1 Dezinfektimi i sistemit

Perpara se të shqyrtohet rrjeti nën presion duhet të bëhet dezinfektimi. Dezinfektimi do të bëhet me përzierje të klorit me më së paku 50 mg/lit të klorit të lirë, i cili do të dozohet me rastin e mbushjes së tubacionit. Në rastet e tubacioneve të reja, sasia e klorit të lirë duhet të jetë $(10 \div 20)$ mg/lit.


Kohëzgjatja e dezinfektimit është prej $(12 \div 24)$ h. Pas këtij procesi, uji i pastër lëshohet në tubacion por më herët se 24h, derisa për kohën e dezinfektimit duhet që së paku një herë të hapet dhe të mbyllet secila valvolë në trase.

Kontrollimi i sasisë së klorit rezidual duhet të matet në pikën më të largët në krahasim me pikën ku është lëshuar klori në tubacion.

Nëse përmbajtja e klorit të përzier është më e vogël se 10 mg/lit, procesi duhet të përsëritet.

Punëkryerësi duhet të lëshojë në natyrë përzierjen e klorit në atë mënyrë që të mos e ndotë ambientin si dhe vijat tjera të ujit dhe për këtë çështje duhet ta marrë edhe mendimin e organit mbikëqyrës dhe do të respektojë çdo urdhër të tij.

- **Plani i situacionit**




Nyja kryesore 1 e kyqjes ne rrjetin e ujesjellesit nga Gypat AC ne gyp PE behet permes pjeseve lidhese fazonike te paraqitura edhe me detale.

Nyjen Kryesore 1 - kuota e sipërme e pusëtes me kordinata X 7506357.24 ,


Y= 4728720.38.

Gjatesia e gypit nga Nyja Kryesore 1 deri te Kthesa Kryesore 1 eshte L=80.0m.



Kthesa kryesore 1 E gypit të ujësjellësit është nga materiali PE bëhet përmes pjesëve lidhëse fazonike të paraqitura edhe me detale.

Kthesa Kryesore 1 - kuota e sipërme e pusëtës është me koordinata $x=7506180.58$, $Y=4729218.75$.



Nyja kryesore 2 e kyqjes në rrjetin e ujësjellesit është PE behet përmes pjeseve lidhëse fazonike të paraqitura edhe me detale.

Nyjen Kryesore 1 - kuota e sipërme e pusëtës është me koordinata $x=7506655.30$,
 $Y=47291176.18$.

Gjatësia e gypit nga Kthesa Kryesore deri te Nyja Kryesore 2 është $L=80.0m$

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <u>gjuha e procedurës - shqipe</u> .
Personeli	9.1	Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës OE, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoj tek Zyra e Prokurimit një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit me afat të vlefshmërie prej 50 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në PJESA IV E KONTRATËS
Siguria në punë	10.2	Kontraktori është përgjegjës për aplikimin e ligjeve për mbrojtje në punë të punëtorëve të tij përveç tjerash edhe duke : - bërë sigurimin e zonave të punës për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt - duke u siguruar në gatishmërinë profesionale të punëtorëve, - duke u siguruar në përdorimin e drejt të veglave dhe mjeteve adekuate dhe funksionale nga punëtorët,

		- duke obliguar punëtorët që të mbajnë uniformat e kompanisë (uniforma duhet identifikuar kompaninë) si dhe rrobat e punës dhe mjetet mbrojtëse në punë si : rroba pune, helmeta, këpucë adekuate varësisht nga natyra e punës dhe stina, syza mbrojtëse,dorëza pune ..etj - nga bartja e uniformës lirohet vetëm menaxheri kryesor – drejtori i kompanisë dhe askush tjetër nga punëtorët e kompanisë, varësisht nga natyra e punës të angazhoj punëtorë me kualifikime adekuate, njohuri dhe përvojë të duhur për kryerjen e punëve të nevojshme. - OE obligohet që paisjet dhe nr.e puntorëve të kerkuar t'i ketë në vendëpunishte gjatë gjithë kohes deri në realizim të projekti.
